



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:119689

Datë: 29.01.2021

Numri i dokumentit: 01458325

C.nr.1087/18

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,** me gjyqtarin Blerim Beshtica dhe bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike të paditëses K. e S.KS “S. U. G. A. “ Sh.A, në Prishtinë, kundër të paditurit B. L - Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti rimbursim i borxhit, vlera e kontestit 3,677.00 €, jashtë seance gjyqësore, më datën 29.01.2021 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**PËR SHKAK TË PADËGJUESHMËRISË/MOSBINDJES**

**I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses K. e S. KS “S. U. G. A. “ Sh.A, në Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri që paditëses t’ia kompensoj mjetet në emër të borxhit kryesor shumë prej 3,677.00 €, së bashku me kamatën ligjore prej 8 % prej datës së paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

**II. REFUZOHET** si e pabazuar pjesa e kërkesa e paditëses K. e S. KS “S. U. G. A me seli në Prishtinë për pagesën e shpenzimeve të procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësja në këtë gjykatë, më datë 18.12.2018 ka dorezuar padi kundër te paditurit me objekt kontesti rimbursim i borxhit me vlerë të objektit 3,677.00 €, duke thesuar që më datë 17.11.2015 ka ndodhur aksident komunikacioni në rrugën Qarkore udhëkryqi ... në Gjilan, kurse sipas Raportit Policor, deri te Aksidenti ka ardhur kur mjetit “A” me targa ... ka qenë duke lëvizur në Rrugën “Arben Isufi”, duke arritur te udhëkryqi, nga moseksperienca, duke mos përshtatur shpejtësinë e mjetit në vendbanim, nuk ndalet në shenjën STOP dhe godet mjetin B, që lëvizte në rrugën qarkore. Në këtë aksident lëndime trupore kanë marrë A. B dhe Q. B. Të dëmtuarit në fjalë kanë paraqitur kërkesë për kompensim të dëmit material dhe jomaterial nëpërmjet të autorizuarit të tyre, pranë paditësit, i cili dëm është shkaktuar nga aksidenti i datës 17.11.2015, ku kërkesa është aprovuar dhe në bazë të marrëveshjes jashtëgjyqësore, paditësja ja ka kompensuar të dëmtuarëve dëmin material dhe jomaterial në vlerë prej 3,677.00 € dhe në fund ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses dhe të detyrohet i padituri që paditëses t’ia kompensoj mjetet në emër të borxhit kryesor shumë prej 3,677.00 €, së bashku me kamatën ligjore prej 8 % prej datës së

paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë në bazë të nenit 387 par.1, pika (a), ka nxjerrë aktvendimin C.nr.1087/18, të datës 27.12.2018 të cilën i padituri e ka pranuar me dt.10.01.2019, fakt ky i vërtetuar përmes fletëkthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurit për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë i njëjti nëse nuk paraqet përgjigje në padi brenda afatit ligjor, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes në disfavor të tij.

Gjykata në kuptim të dispozitave të cekura ligjore nga neni 150 i LPK-së ku e njëjta ka gjetur se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes edhe atë në par. 1, pikat a), b) dhe c) të LPK-së, në të cilat dispozita shprehimisht parashihet se *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadiisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadiia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.”*, e në rastin konkret nga pretendimet dhe provat e bashkëngjitura në padi, gjykata gjeti se vërtetohet themelsia e padisë.

Gjykata nga provat që i janë bashkëngjitur padisë e ka vërtetuar faktin se i padituri ka shkaktuar aksident më datë 17.11.2015 ku në këtë aksident ka pësuar lëndime trupore A. B dhe Q. B., fakte këto të vërtetuara nga Raporti Policor dhe skicat ..., poashtu gjykata ka vërtetuar faktin se personat e lartëcekur kanë paraqitur kërkesë për kompensim të dëmit material dhe jomaterial, ku kjo kërkesë është aprovuar dhe të dëmtuarit A. B dhe Q. B kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore me tani paditësen për kompensimin e dëmit të lartëcekur në shumë prej 3,677.00 €. Gjithashtu gjykata vërtetoi faktin se drejtuesi i automjetit me të cilin ka shkaktuar aksident nuk ka pasur patent shofer dhe si rrjedhojë e kësaj ka humbur dhe mbulesën siguruese, nga kjo bazë ka lindur dhe e drejta e regresit.

Gjykata në kuptim të dispozitave të cekura ligjore nga neni 150 i LPK-së e në lidhje me dispozitat nga neni 245, paragrafi 1 LMD-së i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-077, ku përcaktohet se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndëgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, dhe neni 169 par.1 i cili thotë se *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”* dhe par.2 *“Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla”*, por edhe sipas doktrinës juridike shuarja e detyrimit me anë të përmbushjes është mënyra më e natyrshme e realizimit të prestimit nga ana e debitorit. Kur përmbushja (ekzekutimi) bëhet në mënyrën e duhur dhe në afatin e caktuar, atëherë është arritur qëllimi i detyrimit, kreditori e ka

realizuar të drejtën e tij dhe detyrimi pushon se ekzistuari – shuhet, andaj mbi bazat e lartëcekura gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata për marrjen e këtij vendimi gjithashtu është mbështetur në dispozitat e nenit 960, par.1 të LMD-ës, ku theksohet se *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave të cilet mbi qfarë do baze janë përgjegjës për dëmin”* dhe në dispozitën e nenit 14 par.2 dhe 3 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ku shprehimisht thuhet se *“humb mbulesa siguruese e polisës së sigurimit kur drejtuesi i mjetit që shkaktonte aksidentin është nën ndikimin e alkoholit apo nuk ka dëshmi adekuate për drejtimin e një mjete të tillë”*, e në rastin konkret i padituri nuk ka pasur patent shofer.

Gjykata vendosi për kamatë ligjore prej 8%, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, nr. 04/L-077/ i vitit 2012.

Gjykata në bazë të dispozitës së nenit 463.2 të LPK-së ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sepse, me këtë dispozite është përcaktuar qartë se: *“Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t'i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po qe se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës”*. Më rastin konkret paditësja në padi i kërkuar shpenzimet e procedurës, por e njëjta nuk i ka specifikuar shpenzimet, ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 363.2 të LPK-së, gjykata nga kjo arsye e ka refuzuar kërkesën e paditëses për kompensimin e shpenzimeve të procedurës.

Nga se u tha më lartë, e në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**C.nr.1087/18, dt. 29.01.2021**

**Gjyqtari,**  
**Blerim BESHTICA**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.